



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 1033/3 Prot.

Peshkopi, më datë 30.10.2024

SHPLLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE “SEKRETAR GJYQËSOR”

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 622, date 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor, vendimit nr.84 dt.11.03.2021, Gykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

I. 1 (NJË) POZICION - SEKRETAR GJYQËSOR, KATEGORIA IV-11

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civil gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele. Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë.

- Afati për dorëzimin e dokumenteve për **LËVIZJE PARALELE** është më datë **13 Nëntor 2024;**
- Afati për dorëzimin e dokumenteve për **PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR** është më datë **20 Nëntor 2024;**

II. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHEM I PUNËS PËR POZICIONET SEKRETAR GJYQËSOR:

1. Sekretari gjyqësor kryen detyra procedurale, në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi.
2. Sekretari gjyqësor ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme:
 - vërteton aktet e gjykatës dhe lëshon vërtetime apo kopje të njësuara me origjinalin të akteve

procedurale gjyqësore.

- kur përdoren pajisje regjistrimi apo pajisje që kryejnë funksione të ngjashme, sekretari garanton që regjistrimi ose riprodhimi është origjinal dhe i paprekur;
- është përgjegjës për krijimin e dosjeve dhe ndihmon gjyqtarin për mbajtjen e dosjeve sipas një rregulli të caktuar, si dhe për regjistrimin dhe zbatimin e urdhrave të shpallur apo të nxjerrë nga gjykatat dhe gjyqtarët;
- ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe për regjistrimet në regjistra dhe ndihmon në mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;
- ndihmon në çështje që lidhen me mbajtjen e dosjeve personale;
- bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave gjyqësore;
- ndihmon në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kriterëve të përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave;
- ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

3. Veprimtari të tjera, të cilat kryhen rregullisht nga sekretarët gjyqësorë, renditen në përshkrimet standarde të punës, miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

4. Ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj, të autorizuar nga Kancelari dhe Kryetari i Gjykatës.

III. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

3.1. KUSHTET PËR LEVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë diplomuar në Drëjtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;
- Të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

3.2. DOKUMENTACIONI, MËENYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër dokumentet si më poshtë:

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun : <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik si dhe adresën e vendbanimit
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave;
- Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (Kartë Identiteti);

- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore)
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Vërtetim banimi (saktësim adrese);
- Dëshmi penaliteti.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, brenda datës **13 Nëntor 2024**.

Ankesat nga kandidatet e pakualifikuar paraqiten në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 diteve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

3.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **14 Nëntor 2024**, Kancelari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër do të shpallë në faqen zyrtare të Këshilli i Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të çdo gjykate, listën e kandidateve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

3.4. MËNYRA E VLERESIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi profesional për kandidatët fitues të fazës së parë do të kryhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, sipas një sistemi pikëzimi. Kandidatët do të vlerësohen:

- 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vleresimit në punë;
- 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e Drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës;
- 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën përkatëse

3.5. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, gjkata.gov.al/rrethi-diber/gjykata-e-shkallës-së-parë-e-juridiksionit-të-pergjithshëm-diber/vende-vakante/.

IV. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpallje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Ketë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër duke filluar nga data **14 Nëntor 2024**.

4.1. KUSHTET QË DUHET TË PLOTESOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR DHE KRITERET E VEÇANTA

Sipas nenit 55 të Ligj 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatet jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas Ligj 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të jetë diplomuar në drejtësi, të paktën në nivelin “Bachelor”;
- Të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose cdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën.

4.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun : <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>
- Deklaratë mbi të dhënat e kontaktit elektronik dhe telefonik
- Fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave;
- Fotokopje të noterizuar të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (Kartë Identiteti);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore (formular i vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore)
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Vërtetim banimi (saktësim adrese);

- Dëshmi penaliteti.

Dokumentet duhet të dorëzohen në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, brenda datës **20 Nëntor 2024**.

4.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **21 Nëntor 2024**, Këshilli i Lartë Gjyqësor, do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të çdo gjykate listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër brenda 2 diteve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

V. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTESITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA.

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Kodi i Procedurës Civile;
- Kodi i Procedurës Penale;
- Ligj nr. 49/2012, date 03.05.2012, “Per gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;
- Ligj nr.152/2013 “ Për nënpunësit civil”, i ndryshuar;
- Ligj nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftesitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

VI. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- 60 (gjashtëdhjetë) pikë për testimin me shkrim.
- 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor do të shpallë fituesin në faqen

zyrtare dhe në faqen e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit për rezultatet. Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, gjkata.gov.al/rrethi-diber/gjkata-e-shkallës-së-parë-e-juridiksionit-të-pergjithshëm-diber/vende-vakante/.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzim nr.85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor” të Këshillit të Lartë Gjyqësor publikuar në faqen zyrtare të tij www.klgj.al.

KËSHILLI I GJYKATËS

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DIBËR